

ISP – OPINION PËR PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 84/2017, DATË 21.10.1998 “KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

Falenderime lidhur me mundësinë për tu dëgjuar.

1. Për ISP përbën shqetësim fakti se **Kushtetuta e RSH po ndryshohet në mënyrë të vazhdueshme, për të zgjidhur probleme të momentit**, - e ndryshuam vjet, tani kemi dy nisma të reja për ndryshim dhe mund të kemi të tjera vitin e ardhshëm, - 7 herë prej 1998, duke treguar së paku se nuk kemi arritur të kemi një qasje strategjike dhe vizionare lidhur me rolin dhe vendin e Kushtetutës së RSH. Kushtetuta nuk është përgjegjëse për gabimet e politikës, duke e ndryshua vazhdimisht vetëm sa e dobësojmë atë. **Reforma nisi si eksperiment unik, por nuk mund të vijojë të trajtohet pafundësisht si eksperiment.** Për më tepër, pas 5 vitesh reformë, ka një shumicë publike që kërkon më shumë se kaq, kërkon drejtësi funksionale, transparente dhe të besueshme, objektiv i arritshëm vetëm më 2030 sipas ministrisë së drejtësisë. Në mënyrë simbolike mendoj se ka ardhur koha të ketë një konsensus politik që Kushtetuta të mos trajtohet si ligjet e thjeshta që janë ndryshuar pafundësisht herë në 30 vjet.
2. Debati aktual është më **shumë për një dilemë madhore sesa një debat madhor**, pra nuk po bëhet për ta bërë reformën në drejtësi më efektive apo për të rritur standardet e saj siç thuhet në relacion, por nga dilema nëse pas qershorit 2022 a do arrijë vetingut **të vijojë** me strukturat që aktualisht përcakton Kushtetuta.
3. **Nisma parlamentare ka një paradoks**, - shtyrja e mandatit nuk mund të jetë nismë politike **e një partie politike**, - do të duhej të ishte një akt në përgjigje të një kërkesë të KPK apo KLGJ/KLP, të ONM apo partnerëve ndërkombëtarë. Duke u paraqitur si nismë deputetësh e dobëson argumentin dhe vetë nismën, si dhe i jep natyrë politike. Nuk shoh arsye që në këtë debat të ketë pozicionime politike dhe as përfitime nga një proces jo dhe aq meritor, pas ndryshimeve kushtetuese konsensuale të vitit 2016.
4. Relacionit i mungon një referim i saktë **nëse partnerët ndërkombëtarë** kanë të njëjtin opinion për shtyrjen e mandatit dhe argumentet e tyre për këtë. Nëse SHBA dhe BE, me misionet e tyre asistuese kanë arritur në përfundimin se mandati duhet shtyrë, ky është fakt me rëndësi që duhet marrë seriozisht në konsideratë dhe me siguri, e gjithë shoqëria civile e mbështet. Deri tani është folur në media për një

sugjerim të tillë, por nuk ka asnjë akt zyrtar në dijeninë tonë apo të publikut. **Deklarimet mediatike nuk janë akte zyrtare.** Aktet zyrtare dhe transparencja publike do i jepte më shumë besim nismës dhe integritet më të madh procesit. Ne po ndryshojmë Kushtetutën dhe një procedurë e tillë kërkon seriozitet maksimal.

5. Duke u kthyer tek detajet e nismës, - lidhur me propozimin për shtyrjen e mandatit për vitin 2024, - cila është **garancia e datës fundore** (kur edhe në relacion thuhet, - të paktën dy vjet!), apo do të duhej të hiqej referenca kohore në Kushtetutë? Nëse, larg qoftë, COVID vijon, ndodhin kriza politike ose ngjarje të tjera, - **cila është garancia** se pas 2,5 vitesh nuk do të kemi përsëri ndryshime kushtetuese për një mandat shtesë në nivelin e mandatit të KPA-së?
6. A kemi garanci se KPK dhe IKP me 2,5 vite më shumë do të jetësojnë vettingun dhe se produkti i tyre do të **ofrojë standarde të larta rivlerësimi**? Personalisht do ta merrja me rezerva të mëdha. Gjatë periudhës 2018-2021 KPA ka rrëzuar **25% ose 1 në 4 vendime** të KPK. Kjo është një përçindje shumë e lartë rrëzimi dhe tregues se nuk janë aplikuar të njëjtat standarde për të njëjtat subjekte rivlerësimi. Me të njëjtat raporte kritike të vendimeve të rrëzuara në nivel tjetër vetë KPK ka shkarkuar gjyqtarë e prokurorë. **A kanë vetë KPK dhe IKP të interesuar për përshpejtimin e vettingut apo për shtyrjen më tej të mandatit të tyre? Kam dyshime se ka një lidhje midis këtyre dy elementëve.**
7. Në relacion theksohet se **Komisioni i Venecias** ndikoi në uljen e mandatit nga 9 në 5 vjet, por i njëjti Komision pati deklaruar edhe se Tirana zyrtare u ka dhënë garanci se kemi burime të mjaftueshme njerëzore për funksionimin e sistemit të ri të drejtësisë. Kjo rezultoi e pasaktë, krijoi situatë dramatike dhe pyetja është, - **kush i tha këto garanci atëherë dhe a janë të njëjtat standarde të garancisë që ofrohen edhe në rastin e shtyrjes 2,5 vjet të vettingut?**
8. Relacionit të deputetëve iniciues i mungon edhe vlerësimi e argumenti **nëse Kuvendi ka pyetur zyrtarisht** Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (KPK), **KPA-në, IKP-në, KLGJ-në, KLP-në, SPAK**, etj. Nëse jo, përse? Nëse po, cilat kanë qenë reagimet e tyre? A kanë ato **studime** dhe të dhëna që provojnë se formula aktuale nuk funksionon dhe nisma për dy vite të tjera janë të mjaftueshme për zgjidhje efektive? A ka analiza profesionale si ato që u bënë përpara reformës mbi të cilat të mbështetet vendimi? Kuvendi duhej të kishte një material të tillë të detajuar, i cili të bazohej në fakte dhe pritshmëri dhe të bëhej edhe publik.

9. Nga njëra anë kudo thuhet se **KLJGJ, KLP dhe SPAK janë histori sukcesi**, por kur referohet kompetenca e tyre kushtetuese për vijimin e vettingut, deklarohet se ato **nuk kanë kapacitete, nuk kanë përvojë, nuk ofrojnë garanci, mund të kenë konflikte interesi** dhe mund të ndryshojnë standardet e vettingut! Ose duhet të pranojmë vlerësimin e parë ose të dytë, të dyja nuk shkojnë bashkë. ISP është dakord me perceptimin e përgjithshëm se KLJGJ dhe KLP nuk kanë arritur të fitojnë besimin publik, se premtimi për qasje profesionale dhe vizionare të reformës në drejtësi ende nuk ka ardhur dhe se vetëm disa struktura si KPA, ILD apo SPAK po bëjnë dallimin pozitiv.
10. Në aspektin financiar, qytetarët paguajnë rroga mujore me shifra shumë të lartë, gati dy herë më shumë se edhe vetë deputetët e zgjedhur nga qytetarët për secilin anëtar të KLJGJ dhe KLP dhe 2-3 herë më tepër anëtarët e KPK dhe IKP-së. Kjo është një kosto e madhe për një vend të varfër, dhe është e **vështirë të thuhet se ka një balancë midis kostos që paguajmë dhe produktit që marrim**. Për më tepër, KLJGJ dhe KLP do ndryshojë muajin tjetër në një të tretat, KPA ka humbur një anëtar, dhe një **prej dy komisionerëve publikë** është zgjedhur për në Gjykatën e Lartë, gjë që do duhet të çojë në zëvendësimin e tij.
11. Nëse Kuvendi do e dërgojë në **Komisionin e Venecias për opinion. Konsultimi do të kishte vlerë pas shprehjes së Komisionit, jo përpara**. Sepse çdo vlerësim i konsultimeve apo ekspertëve të palëve në Kuvend, do të zhvleftësohej nga çdo variant i opinionit në Venecia. Këtë e provuam edhe në rastin e **ndryshimeve Kushtetuese të vitit 2020**, kur disa nga kritikantët morën konfirmim nga opinioni i mëvonshëm në Venecia apo nga Gjykata Kushtetuese, ndërkohë që në parlament nuk u morën në konsideratë, përkundrazi, zëra të shoqërisë civile u denigruan nga ekspertët, gjë që solli edhe reagimin tonë publik.
12. Për ISP çdo zgjidhje që do të jepet nga Kuvendi mbetet e mangët, por nevoja për ta jetësuar reformën në drejtësi dhe për të pasur sukses me këtë reformë, dominon nga elementët e tjerë kritikë. Ndaj ne apelojmë që Kuvendi krahas vendimit, të iniciojë një rishikim të pozicionit të vet ndaj reformës në drejtësi, si dhe të ketë qasje të re ligjore për të forcuar ILDKPKI, SPAK, KLJGJ, KLP, etj, në mënyrë që pas 2-3 vitesh këto institucione të bëhen efektive dhe të besueshme dhe që garancia afatgjatë të vijë nga institucionet funksionale, jo nga vendimmarrjet politike. Kuvendi duhet ta ushtrojë rolin kushtetues jo vetëm për miratimin e ligjeve, por edhe për ndjekjen e jetësisimit të tyre, sidomos në drejtësi, si dhe të ketë qasje të re, për zgjedhje të

individëve mbi bazën e meritokracisë, konkurrencës reale dhe aftësisë, ndryshe nga praktika e zgjedhjeve të sforcuara të individëve “me letra në rregull”.

13. Në këtë proces Kuvendi do të duhet të marrë në konsideratë edhe **vlerësimin e konfliktit të interesit**, sepse në vlerësimin tonë nisma ka elementë të konfliktit të interesit. Po ashtu, Kuvendi duhet të garantojë se vendimmarrja parlamentare të mos ndikohet nga procese gjyqësore dhe hetimore paralele që mund ti pamundësojnë ato apo nga përpjekje për të lobuar në favor të palëve të treta.
14. Së fundi, një element teknik, por që mendoj se ka vlerë për solemnitetin e Kuvendit dhe ndryshimeve kushtetuese, - nëse nuk do të ishim organizatë që monitoron Kuvendin dhe për pasojë i njohim deputetët në mënyrë të thelluar, do ta kishim të vështirë të identifikonim **së paku 4-5 emra deputetësh iniciues, emrat e të cilëve janë shënuar të paplotë, të palexueshëm dhe të pa referueshëm në një dokument kaq zyrtar e strategjik**. Kuvendi duhet të krijojë një praktikë protokollare pune që zgjidh përfundimisht këtë problematikë teknike, por me rëndësi për memorien dhe integritetin institucional të tij.